



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
RAHOVECIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Edon Kabashi Udhëheqës i ekipit dhe Elvir Krasniqi, Anëtar nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	30
Shtojca III: Letër konfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 03/11/2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç buxhetit final, i cili ishte prezantuar gabimisht në vlerë 11,738,000€ duke e nënvlerësuar buxhetin për 437,213€ (buxheti final sipas të dhënave të thesarit ishte 12,175,359€).


Theksimi i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 77,221€, si dhe ato për subvencione dhe transfere në vlerë 60,865€, ishin buxhetuar, dhe realizuar gabimisht nga investimet kapitale;
- Pasuria e shpalosur në pasqyrat financiare vjetore nuk ishte e saktë; dhe
- Detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare, ishin nënvlerësuar për 29,312,700€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Rahovecit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklaratat e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

1. Opinioni i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Tek neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, buxheti final, është prezantuar gabimisht në vlerë 11,738,000€ duke e nënvlerësuar buxhetin për 437,213€ (buxheti final sipas të dhënave të thesarit ishte 12,175,359€). Gabimet ishin reflektuar edhe tek shpalosjet e PFV-ve. Kjo ka ndodhur për shkak se gabimisht janë vendosur të dhënat financiare për shumën e mjeteve të alokuara për kategori ekonomike në vend të vlerave të buxhetit final.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat

janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 77,221€¹, si dhe për subvencione dhe transfere në vlerë 60,865€², ishin buxhetuar, realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Keq-klasifikimet kishin ndikim në dy pasqyrat kryesore si dhe të shpalosjet e kategorive të caktuara;
- Komuna nuk kishte arritur t'i evidentoj në regjistrin kontabël, pasuritë e blera gjatë vitit (investimet kapitale) në vlerë 526,279€³;
- Nga gjithsej 1140 parcela në pronësi komunale, komuna ka evidentuar 1011⁴ parcela, me diferencë 129 parcela, të cilat kanë mbetur të pa evidentuara dhe vlerësuar;
- Komuna nuk e ka përfshi në regjistrin e pasurisë objektin shkollor "Selajdin Mullabazi" të ndërtuar nga MASHT-i; dhe
- Sipas regjistrit të siguruar nga avokati publik i komunës, obligimet kontingjente janë në vlerë 32,499,129€⁵, ndërsa vlera e detyrimeve kontingjente e prezantuar në PFV ishte 3,304,000€, duke nënvlerësuar ato për 29,195,129€.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Rahovecit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga

¹ "Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve" - 19,745€, "Rrënim i objekteve pa leje" - 9,013€, "Sigurimi fizik i objekteve dhe shërbimi i pastrimit" - 14,430€; "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve nga mbeturinat" - 10,000€; "Mirëmbajtje e parqeve dhe të varrezave" - 9,356€; "Blerje të pajisjeve të teknologjisë informative" - 4,693€; dhe "Dreka zyrtare" - 9,984€.

² "Sera të fermerëve" - 40,865€; "Projekti për ngritjen e përkujdesit shëndetësor ambulant dhe shërbimeve sociale në familje" - 20,000€.

³ Nga blerjet totale nga investimet kapitale për vitin 2017 në vlerë 3,536,486€, komuna kishte regjistruar vetëm 2,464,704€, me diferencë 1,071,782€. Sipas konfirmimit nga komuna, investimet kapitale të pa regjistruara 526,279€, ndërsa pjesa tjetër sipas komunës nuk është evidentuar sepse janë mallra dhe shërbimeve si dhe subvencione dhe transfere të cilat ishin keq-klasifikuar si kapitale.

⁴ Vetëm këtë vit janë evidentuar në regjistrin kontabël 67 parcela në vlerë prej 545,503€.

⁵ Përpos kësaj vlerë, në raportin e avokatit të komunës janë të prezantuara edhe disa detyrime kontingjente në dinarë, në vlerë 13,962,641 din.

mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar me disa gabime, si:

- Pasuritë nën 1,000€ të shpalosura në PFV ishin në vlerë 701,000€, derisa sipas një regjistri të mbajtur në Excel pasuria e evidentuar ishte në vlerë 684,236€, me diferencë 16,764€. Për me tepër komuna nuk ka aplikuar zhvlerësim asnjëherë, që nga koha e blerës se tyre; dhe
- Komuna nuk ka të angazhuar Zyrtarin Kryesor Financiar (ZKF). PFV-të nënshkruhen nga drejtori i financave, që është në kundërshtim me LMFP dhe rregullën 01/2017 të Thesarit.⁶

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale, më përjashtim të çështjeve të prezantuara te baza për opinion të kualifikuar.

Të gjitha kërkesat tjera për raportim si në kontekst të PVF-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur.

⁶ Pasqyrat duhet të nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar. Çdo organizatë buxhetore, duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar me status të nëpunësit civil.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale, regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale, detyrimeve kontingjente, si dhe të siguroj se komuna ka plotësuar pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar me status të nëpunësit civil.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Rahovecit kishte shpenzuar 96% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Edhe pse Komuna e Rahovecit ka bërë një numër përmirësimesh, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar nuk janë shqyrtuar mjaftueshëm nga menaxhmenti.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat nuk ishin efektive dhe nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur. Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt. Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet shqetësim për komunën, për shkak se nuk janë zbatuar sa duhet rregulloret, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë monitorimi i subvencioneve si dhe menaxhimi dhe raportimi i pasurisë dhe obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁷	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,908,739	12,175,359	11,661,181	11,567,016	11,473,317
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,661,007	10,616,798	10,591,533	10,420,032	10,403,275
Të bartura nga viti paraprak ⁸	-	210,194	205,751	245,380	256,666
Të hyrat vetjake ⁹	1,247,732	1,247,732	769,469	801,797	746,922
Donacionet e brendshme	-	6,112	-	5,400	-
Donacionet e jashtme	-	89,195	89,100	94,407	66,454
Huamarrja	-	5,328	5,328	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 266,620€. Kjo rritje është rezultat i zvogëlimit të grantit qeveritar për 44,209€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak 210,194€, huamarrja 5,328€, donacioneve të brendshme për 6,112€ dhe të jashtme për 89,195€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar rreth 96% të buxhetit final ose 11,661,181€, apo realizim të njëjtë më vitin 2016 (96%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,908,739	12,175,359	11,661,181	11,567,016	11,473,317
Pagat dhe Mëditjet	7,028,178	7,017,400	6,991,962	6,966,078	6,818,898
Mallrat dhe Shërbimet	706,110	712,987	694,080	657,625	771,189
Shërbimet komunale	250,500	250,500	249,753	250,497	280,665
Subvencionet dhe Transferet	191,322	191,322	188,900	173,992	142,160
Investimet Kapitale	3,732,629	4,003,150	3,536,486	3,518,824	3,460,405

⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁸ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁹ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit final për paga dhe mëditje për 10,778€, është si rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura për 8,431€ dhe zvogëlimit me vendim të qeverisë për 19,209€;
- Buxhetit final për mallra dhe shërbime është rritë për 6,877€, si rezultat i të hyrave të bartura për 375€, të hyrave nga donacionet e jashtme për 1,174€ dhe financimi nga huamarrja për 5,328€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 270,521€. Fillimisht ishte rritur për 295,520€ (të hyrave të bartura në vlerë 201,389€, dhe donacionet e jashtme 94,131€), ndërsa në fund të vitit ishte reduktuar me vendim të qeverisë për 24,999€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2017 ishin në vlerë 820,959€, të cilat janë realizuar nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative, etj. Auditimi ka shpalosur, se ekziston nevoja për përmirësimin e disa proceseve dhe kontrolleve që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së inkasimit të tyre, si dhe saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹⁰	2017 Pranimet	2016 ¹¹ Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,247,732	1,247,732	820,959	1,009,926	969,696

Përpos të hyrave të rregullta të prezantuara, komuna gjithashtu ka pranuar edhe të hyra nga gjobat e trafikut dhe dënimet e gjykatave në vlerë 118,288€¹²të cilat janë mbledhur nga institucionet qendrore.

¹⁰ Në planifikimin e të hyrave me buxhet fillestar dhe final komuna ka përfshi edhe planifikimin e të hyrave indirekte.

¹¹ Pranimet për vitin 2016 dhe 2015 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

¹² Gjobat/dënimet e Policisë së Kosovës nga trafiku 77,458€ dhe Gjobat/dënimet nga Gjykata 40,831€.

Çështja 2 - Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe UA në fuqi. Nga gjithsej 13,075 prona deri më tani komuna ka arrit të verifikoj vetëm 444 prej tyre, ose pak mbi 3%.

Sipas Ligjit mbi tatimin në pronë, neni 9, ceket se çdo person fizik, i cili më datë 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Komuna në dy raste, nuk kishte respektuar këtë kërkesë ligjore, duke aplikuar zbritjen prej 10,000€, për dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesor për të njëjtin tatimpagues. Mangësitë e tilla lidhen direkt me pamundësinë e komunës për të bërë verifikimin e pronave dhe për të identifikuar problemet.

Rreziku Mos përditësimi i të dhënave që lidhet edhe me verifikimin e 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që komuna të ketë më pak të hyra nga kjo kategori.

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që bëhet verifikimi i 1/3-tës të pronave, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë. Veprime shtesë duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet vetëm për vendbanimet kryesore.

Çështja 3 - Vonesa në arkëtimin e qirasë

- E gjetura** Në dy raste komuna si qiradhënës, nuk kishte inkasuar të hyrat e qirasë në përputhje me kushtet e kontraktuara. Sipas kontratës për dhënie në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme (objekte afariste) qiraja mujore duhet të paguhet më së largu deri në ditën e 5-të të muajit në vijim nga ana e qiramarrësit, mirëpo komuna nuk aplikonte faturim të rregullt sipas kontratës dhe në këto raste të hyrat nuk inkasohen me kohë dhe evidenca për llogarit e arkëtueshme mund të mos jetë e plot.
- Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna me qira si dhe mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për inkasimin e të hyrave, rritë rrezikun e mos realizimit të planit të të hyrave dhe reflekton me më pak projekte kapitale të cilat janë planifikuar të financohen prej tyre.
- Rekomandimi 3** Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave konform kushteve të kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për arkëtimin e mjeteve nga qiraja.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Shpenzimet për paga gjatë vitit 2017 janë 6,991,962€ apo afër 100% e buxhetit të planifikuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën.

Çështja 4 – Menaxhim jo adekuat i dosjeve/të dhënave të personelit

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur ende të kompletoj dosjet e personelit në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2011 “Mbi dosjet dhe regjistrin qendror për shërbyesit civil”.
- Në katër dosje të shërbyesve civil mungonin dokumentet si: certifikata e lindjes, shtetësisë dhe vërtetimet se punonjësit nuk janë nën hetime, ndërsa në një rast tjetër, mungonin: letërnjoftimi, kualifikimi dhe trajnimet, formularët e aplikimit dhe vlerësimit dhe referencat nga punëdhënësit e mëparshëm; dhe
 - Te punonjësit e arsimit dhe shëndetësisë në dhjetë raste dosjet nuk ishin të kompletuara: në dy raste mungonte certifikata e lindjes dhe shtetësisë, në disa raste tjera mungonte letërnjoftimi, formularët e aplikimit, vlerësimet e punës, format e pushimit mjekësore, si dhe në të gjitha rastet mungonte vlerësimi i formularit të aplikimit dhe vërtetimet se punonjësit nuk janë nën hetime. Gjithashtu komuna nuk kishte një politikë (rregullore të shkruar) sa i përket menaxhimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve për këta sektor. Te punonjësit e arsimit/mësimdhënësit, vlerësimet e performancës kërkohen sipas UA nr. 14/2013.
- Rreziku** Mos azhurnimi i dosjeve dhe mos kompletimi me dokumentacionin e nevojshëm, rrit rrezikun për menaxhim jo adekuat të stafit dhe reflekton me parregullsi dhe mungesë të informatave për stafin e punësuar.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim të menaxhimit të stafit, si dhe matjes së performancës së tyre (vlerësimit vjetor të punës). Për vlerësimin e performancës, komuna duhet të nxjerrë akt (politikë) të brendshëm.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 është 963,487€. Prej tyre janë shpenzuar 694,080€ për mallra dhe shërbime dhe 249,753€ për shpenzime komunale.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, etj.

Çështja 5 - Lidhja e kontratës pa procedura të prokurimit

- E gjetura** Në dy raste, te kontratat: “Shërbime të internetit” dhe “Ofrimi i shërbimeve në grumbullimin e mbeturinave” ishin lidhur pa procedura të prokurimit, duke kontraktuar çmimin mujor 15€ për secilën. Shërbimet ishin kontraktuar sipas marrëveshjes që ishte lidhur/nënshkruar direkt nga drejtori i shkollës me operatorin ekonomik.
- Rreziku** Mos aplikimi i procesit të prokurimit, zvogëlon transparencën për shpenzimin e parasë publike dhe komuna mund të marrë shërbime me çmime jo të favorshme (konkurruese) që reflekton në shpenzimin e parregullt të buxhetit për këtë kategori.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës të sigurohet që është duke u aplikuar Ligji i Prokurimit Publik, me qëllim që çdo shërbim të kontraktohet duke u bazuar në konkurrencë.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 191,322€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 188,900€ apo 99% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve bujqësore, kulturore, sportive, bursa për studentë dhe ndihma momentale.

Çështja 6 - Dobësi në ndarjen e subvencioneve

- E gjetura** Te kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ne identifikuam parregullsi si në vijim:
- Sipas vendimit të kuvendit komunal dhe marrëveshjes “Për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit” në mes komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Rahovec, komuna ka bërë dy pagesa në vlerë totale 21,118€ për shërbime të cilat i ka ofruar Bashkësia Islame. Këto pagesa nuk ishin bërë në llogari të Bashkësisë Islame siç ishte e përcaktuar me neni 6, të kësaj marrëveshjeje, mirëpo janë bërë në llogari private të

personit fizik. Arsytimi i realizimit të pagesave në këtë formë ishte sepse Këshilli i Bashkësisë Islame dega Rahovec nuk ka llogari bankare; dhe

- Me rastin e pagesës për mbulimin e shërbimeve të varrimit për qytetarët e komunës, në shumë raste Zyra e gjendjes civile nuk ka bërë përmirësimet në regjistrin e gjendjes civile. Personat e vdekur nuk ishin larguar nga ky regjistër, për të cilët Bashkësia Islame ka kryer shërbime dhe komunës i ka ofruar dëshmitë e nevojshme për vdekjet siç kërkohet me nenin 47.7 dhe 47.8 të ligjit për gjendjen civile.

Rreziku Pagesat në llogarinë private rrisin rrezikun që subvencionin të mos arrijnë destinacionin e duhur dhe mundëson keq menaxhimin apo keq përdorimin e mjeteve nga përfituesit. Mos shlyerja e personave të vdekur nga regjistri i gjendjes civile paraqet evidenca të pasakta për komunën.

Rekomandimi 6 Kryetari të siguroj se pagesat bëhen në llogari zyrtare të përfituesit të subvencionit si dhe të sigurojë se janë marrë masa adekuate për tu siguruar se regjistri i gjendjes civile është duke u azhurnuar në baza të rregullta.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,003,150€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,536,486€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve dhe shkollave, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale.

Çështja 7 - Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore

E gjetura Në vitin 2017, komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale më shumë se sa mjetet e ndara me ligjin për ndarjet buxhetore, që është në kundërshtim me nenin 9.3 të LPP. Te “Ndërtimi i rrugëve me kubza në Dobidol, Palluzh, Ratkoc, Gexhe, Kramovik dhe Guri i Kuq” si dhe te “Ndërtimi i rrugës në Drenoc, Qifllak, Denjë, Malësi e Vogël dhe Opterush”, shuma e ndarjeve buxhetore për tri vite ishte vetëm 213,001€ ndërsa vlera e kontratave të lidhura 545,868€. Deficiti i fondeve në raport me kontratat e lidhura ishte 332,867€. Kjo për shkak të planifikimit buxhetor jo adekuat të komunës.

Rreziku Hyrja e komunës në kontrata, pa zotimin e mjaftueshëm paraprak të fondeve, dhe të pa parashikuar në kornizën afatmesme buxhetore, rritë rrezikun e vonësive në realizimin e këtyre projekteve apo rrezikojnë edhe ekzekutimin e plotë të tyre.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj kontrollin të shtura të kontraktimit, në mënyrë që para se të hyhet në obligime kontraktuale, fondet buxhetore të jenë të zotuara. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunës.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale. Sipas raportit të zyrës së prokurimit janë nënshkruar 57 kontrata nga 75 të planifikuara apo 76 % e tyre.

Çështja 8 – Vonesa në ekzekutimin e pagesave

- E gjetura** Në 14 raste, pagesat për faturat e pranuar nuk ishin ekzekutuar brenda afatit prej 30 ditëve. Vonesat ishin nga dy deri në 17 muaj. Sipas Rregullës Financiare 01/2013 shpenzimi i parasë publike, neni 44, “çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.
- Rreziku** Vonesat në pagesën e obligimeve brenda afatit ligjor mund të rezultojë me rritje dhe akumulim të obligimeve komunale, përballje me organet e drejtësisë apo shpenzime shtesë për komunën, si ndëshkim për interesin, shpenzime gjyqësore etj.
- Rekomandimi 8** Kryetari të sigurohet se është vendosur disiplinë e duhur financiare që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit dhe mbajtjes në kontroll të obligimeve kontraktuale.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2017 ishte 62,305,000€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 701,000€. Stoqet në fund vit ishin 13,040€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Komuna e Rahovecit nuk kishte bërë përmirësime të dukshme sa i përket regjistrimit të pasurive komunale edhe pas rekomandimit të dhënë në raportin e vitit të kaluar si dhe këshillave të dhëna në memorandumun e auditimit për fazën e ndërmjetme.

Çështja 9 – Menaxhimi i dobët i pasurive

E gjetura Regjistri i pasurive nën 1,000€ (E-Pasuria) nuk azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxheri i pasurisë. Në këtë regjistër janë të regjistruara edhe tokat komunale që është në kundërshtim me nenin 24.2 të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare 02/2013.

Pasuritë e komunës nuk janë të pajisura plotësisht me bar-kode siç kërkohet me nenin 6.4 të rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiar 02/2013. Pasuritë në administratë ishin pajisur me bar-kode, mirëpo jo edhe në QKMF dhe shkolla.

Rreziku Evidentimi jo i plotë i pasurive dhe mos azhurnimi në regjistrat adekuat, shkakton rrezikun e keqpërdorimit, humbjes apo tjetërsimit të pasurisë, si dhe nuk mundëson shpalosjen e tyre të saktë dhe të plotë në PFV.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 2,151,000€. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, taksat e aktivitetit të biznesit dhe qiratë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 është prezantuar në vlerë 2,243,767€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Çështja 10 - Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të ketë një menaxhim dhe raportim të mirë të obligimeve të saj. Në vijim kremi prezantuar mangësitë, si:

- Në raport me vitin paraprak obligimet janë rritur për 1,323,219€ (nga 920,000€ sa ishin në vitin 2016 në 2,243,767€). Rritja enorme e obligimeve në raport me vitin paraprak ishte pasojë e kontrolleve të dobëta, përkatësisht hyrjes në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme;
- Në katër raste faturat e pranuar nuk janë evidentuar në librin e protokolimit të faturave siç kërkohet me nenin 24.1.3 të Rregullës Financiare 01-2013 MF - Shpenzimin e parasë publike; dhe
- Në një rast fatura e papaguar për ndërtimin e kanalit të ujërave atmosferike për muajin tetor të vitit 2017, në vlerë 24,795€ nuk është përfshirë në regjistrin e obligimeve duke nënvlerësuar obligimet e prezantuara për të njëjtën vlerë. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 17.3 të rregullores së Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar të OB.

Rreziku Shumat e raportuara të detyrimeve të pa paguara janë shumë domethënëse për buxhetin e komunës, dhe si të tilla, mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore. Obligimet e larta mund të pasojnë edhe me ekzekutimin e buxhetit përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesat shtesë për shpenzime përmbarimore. Mungesa e protokolimit me rastin e pranimit të faturave, rritë rrezikun e pagesës së dyfishtë, humbjes së faturave, raportimit të mangët dhe jo të saktë të obligimeve dhe mund të rezultojë me vonesa në përmbushjen e obligimeve.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të forcoj kontrollin lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Duhet të siguroj se në librin e protokollit, do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje, të krijojë një sistem efektiv të kontrollit në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Komunës së Rahovecit të vitit 2017, ka rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Po ashtu raporti i auditimit për PFV 2016, ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal.

Megjithatë edhe përpos kësaj, niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte i ulët. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime janë zbatuar, dy të tjera janë në proces të zbatimit dhe nëntë rekomandime nuk janë zbatuar ende.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe trembëdhjetë 13 rekomandime (dy të zbatuara, dy të tjera ishin në zbatim e sipër dhe nëntë të pa zbatuara). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 11 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të nga ZKA-së, vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Komuna nuk aplikon ndonjë masë apo aktivitet të shtuar për zbatimin e rekomandimeve të ofruara nga auditori.

Moszbatimi i rekomandimeve ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare kyçe, si:

- Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Menaxhimi jo i duhur i pasurive dhe obligimeve të komunës; dhe
- Mungesë të procesit të raportimit dhe llogaridhënies menaxheriale;

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen brenda afateve të parapara, të rishikohen dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohen nga të gjitha Organizatat Buxhetore, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

Mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komuna posedonte planin e integruar (2016-2018), planin e modalitetit urban (2016-2020), planin e menaxhimit të mbeturinave (2016-2021), planin zhvillimor komunal (2011-2020) dhe planin gjeneral urbanistik i vitit 1987. Megjithatë, ende mungonin planet tjera strategjike si: planet hapësinore, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Auditimi i Brendshëm nuk kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, për arsye të mos funksionalizimit të komitetit të auditimit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. NjAB gjatë vitit 2017 kishte planifikuar dhe realizuar shtatë raporte të auditimit.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 12 - Mangësi në funksionimin e NjAB-it dhe KA-së

E gjetura	<p>Ekzistojnë dobësitë në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NjAB nuk kishte përgatitur raporte për nivelin e zbatimit të rekomandimeve; • Aktivitetet e auditimit të NjAB kryesisht përfshin periudhën e vitit të kaluar, 2016; dhe • Komiteti i Auditimit (KA) nuk ishte funksional gjatë vitit 2017. <p>Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e angazhimit të menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.</p>
Rreziku	<p>Mbulueshmëria jo e mjaftueshme e auditimit të vitit aktual dhe aktiviteteve operative në proces ndikon në mosidentifikimin e dobësive aktuale duke rezultuar me joefikasitet në dhënien e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme. Njëherit, mos funksionimi i KA-së në këtë drejtim, redukton efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identikuara.</p>
Rekomandimi 12	<p>Kryetari të siguroj se fushëveprimi i NjAB-së, të mbulojë sa më shumë periudhën aktuale duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim. Njëkohësisht, të sigurohet një fokus më i lartë i menaxhmentit në funksionalizimin e KA-së drejtë përmbushjes së këtij qëllimi.</p>

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 13 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, planifikimi dhe procesi i dobët i prokurimit, vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme, dhe vonesat në pagesën e obligimeve, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve nuk kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata janë subjekt i shqyrtimeve gjyqësore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsisive. Pra nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së dhe komuna nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatit ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënës për keq klasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Në proces të zbatimit pasi një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve mbeten për tu zbatuar.	
2.4 Lista kontrolluese e Vetëvlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit të jetë më kritik dhe të siguroj adresimin e fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të rishikohet mundësia e azhurnimit të strategjisë së zhvillimit komunal e cila do të përfshinte objektivat e qarta dhe arritjen e synimeve komunale. Po ashtu, të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për të siguruar dëshmitë mbështetëse lidhur me pohimet e vetëvlerësimit.		Është në proces të finalizimit plani strategjik, mirëpo lista e rreziqeve ende nuk është hartuar.	

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të bëjë planin e veprimit, i cili duhet të zbatohet, duke i konfirmuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve. Auditimi brendshëm duhet të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual, me efekt parandalues të veprimit. Për të fuqizuar rolin e auditimit të brendshëm, Komiteti i Auditimit duhet të funksionalizohet.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Qasja ndaj planifikimit buxhetor për projekte kapitale ka nevojë për përmirësime thelbësore. Para se të përcaktohen fondet për investime, komuna duhet të analizoj me kujdes dhe objektivitet se cilat projekte janë prioritare dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Procedurat e filluara me kohë (hartimi i projektit, sigurimi i ekzekutimit, prokurimi, etj.) janë disa nga parakushtet që projektet të realizohen sipas planit.	Po		

3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar. Të siguroj se komuna nuk do të hyjë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore të parashikuara me ligjin e ndarjeve buxhetore.		Përkundër përmirësimeve, ende mbetet të zbatohet planifikimi, hyrja në obligime konform ndarjeve buxhetore si dhe hartimi i planit të prokurimit gjithëpërfshirës.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë ta shqyrtoj rastin pse Menaxheri i Projektit nuk ka zbatuar kushtet e kontratës si dhe të siguroj se paramasat, paralogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen, janë kryer në mënyrë të hollësishme, dhe devijimet nga kontratat fillestare të jenë brenda limiteve të lejuara. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësive.			Nuk janë marrë masa.
3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëj pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjeronim që praktikat e tilla të pagesave të ndërpriten.			Nuk janë marrë masa.
3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta si dhe të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për nevoja reale dhe jo të angazhohen për pozita të zakonshme.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i orareve të kujdestarive në QKMF në mënyrë që të mos tejkalohet numri i orëve shtesë dhe të respektohet ligji i punës.	Po		

3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroi shkëputjen e kontratave ashtu siç e parasheh vendimi i KK për qiramarrësit të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj komunës. Në të ardhmen, të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë	Kryetari duhet që pa vonesë të formoj komisione kompetente për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Procesi i regjistrimit të pasurive me vlera më të larta se 1,000€ në SIMFK, duhet të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se politikat dhe masat adekuate do të ndërmerren për të maksimizuar inkasimin e borxheve. Është e nevojshme që të bëhet një analizë e detajuar që përcakton arsyet e ngecjes së pagesave, si dhe të propozohen veprimet konkrete dhe burimet e nevojshme për mbledhjen e këtyre borxheve.			Nuk janë marrë masa.

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabimet.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Rekomandimet e vitit paraprak	Ne kemi vërejtur se komuna edhe pse kishte caktuar një grup për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ende ka një ngecje në zbatimin e plotë të tyre. Grupi për monitorim të zbatimit të rekomandimeve kishte mbajtur disa takime ku kishte diskutuar lidhur me mundësin e zbatimit të rekomandimeve. Megjithatë, nevojitet një proces konfirmues për shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e plotë të tyre. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësimet e vazhdueshme në komunë.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të bëjë rishikimin final për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese, para se e njëjta t'i dorëzohet MF.			Nuk janë marrë masa.
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të hartoj planet strategjike dhe të vendos objektiva të qarta të zhvillimit në gjithë sektorët e komunës, si dhe të njëjtat të monitorohen në mënyrë sistematike për të vlerësuar planifikimet fillestare dhe progresin në arritjen e objektivave në periudhat e caktuara.			Nuk janë marrë masa.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ dhe të bëhen raportimet mujore me shkrim nga drejtorët tek menaxhmenti. Po ashtu, të merr masa për t'u siguruar se raportimet nga ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.		Përkundër përmirësimeve, ende mbetet sfide forma mujore e raportimit financiare dhe operativ me shkrim nga drejtorët tek menaxhmenti.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se auditimi brendshëm do të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual dhe kontributi i tij të jetë më produktiv përmes raporteve kualitative. Po ashtu, të siguroj që komiteti i auditimit të funksionalizohet brenda një periudhe të arsyeshme.		Plani vjetor është përmbushur, mirëpo fokusi për aktivitetet në vitin aktual ende mbetet sfidë si dhe komiteti i auditimit ende nuk ishte funksional.	
3.1.1 Te hyrat	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të të hyrave nga tatimi në pronë do të merret parasysh trendi i inkasimit të periudhave të mëparshme dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, siç parashihet me ligj. Duhet të administroj me kujdes të gjitha pronat komunale dhe të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike në rastet e mos kryerjes së detyrimeve financiare ndaj komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të analizoj arsyet pse në rastet e mësipërme nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit me konsistencë dhe në të ardhmen siguroj se janë shpërblyer OE me çmimet më të volitshme për komunën, si dhe do të bëhet me shkrim njoftimi i OE për eliminim nga tenderi.	Po		
	Kryetari duhet të zbatoj kërkesat e ligjit dhe rregulloreve financiare që të mos hyj në kontrata me operatorët, para se t'i zotoj fondet e duhura dhe të siguroj se nuk do të hyjë në obligime kontraktuese përtej ndarjeve buxhetore të parashikuara me ligjin për buxhetin vjetor.			Nuk janë marrë masa.

	Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit të respektoj në përpikëri kërkesat e dosjes së tenderit, në mënyrë që lidhja e kontratave të bëhet me OE të përgjegjshëm dhe procedurat të jenë plotësisht transparente.	Po		
3.2.1 Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit të E-pasurisë dhe të fuqizoj kërkesat që të gjitha pasuritë dhe stoqet nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim, dhe të propozoj masa konkrete, duke mos i përjashtuar edhe masat administrative dhe të tjera (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të analizoj me një kujdes të madh arsyet pse komuna në mënyrë të pa kontrolluar krijon obligime, financimi i të cilave nuk është aspak i sigurt. Rrjedhimisht, duhet t'i forcoj kontrollet që ndërlidhen me obligimet dhe të siguroj se nuk do të hyj në obligime kontraktuese, pa e pasur të sigurt burimin e fondeve.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. *Smajl Latifi*
Kryetar i Komunës,
Data: *21* Qershor.2018, Rahovec,

